

Muaji i Ramazanit dhe Shpërblimet e Këndimit të Kur'anit

Jasin el-Xhiburi

Muaji i Ramazanit është i shenjtë sepse është muaji në të cilin u shpall Kur'ani dhe në sajë të faktit se përmban Natën e Kadrit. Prandaj, është me vend të dihet diçka mbi vlerën e leximit të këtij Libri, më të madhit të të gjitha shpalljeve hyjnore, më të mirit të zbulesave që pasardhësit e Ademit (a.s.) kanë marrë nga Zoti i tyre.

I Dërguari i Allahut (s) citohet në vëllimin II, f. 261 të veprës *Rabi'ul-Ebrar* të Zemakhsheriut, të ketë thënë: “Allahu Fuqplotë i ka recituar Suret Ta-Ha dhe Ja-Sin njëmijë vjet përpara se të krijonte Ademin, dhe kur e dëgjuan, melekët thanë: ‘Përgëzime për ata të cilëve u zbritet një fjalë e tillë, urime për zemrat që e mbajnë atë dhe u lumtë gjuhëve që e shqiptojnë!’” Në po këtë referencë, i Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë: “Zemrat ndryshken porsì hekuri.” Dikush e pyeti: “O i Dërguari i Allahut, ç’ua largon atyre ndryshkun?” dhe ai u përgjigj: “Këndimi i Kur'anit dhe kujtimi i vdekjes.”

Në një hadith kudsì, Allahu i Madhërishëm ka thënë: “Atij që është shumë i zënë me këndimin e Kur'anit për të M'u lutur do t'i jap më të mirën e asaj që u jap atyre që Më janë mirënjohës.”

Imam 'Aliu ka thënë: “Ai që këndon Kur'an në namaz do të fitojë njëqind shpërblime për çdo ajet që reciton; nëse e këndon ndenjurr do të fitojë pesëdhjetë shpërblime për secilin varg dhe nëse këndon pas abdesit do të marrë njëzet e pesë sevape për çdo ajet, kurse ai që e reciton pa abdes do të marrë dhjetë shpërblime për çdo ajet që këndon.”

Zemakhsheriu tregon në vëll. II, f. 264 të veprës së tij *Rabi'ul-Ebrar*, se i Dërguari i Allahut (s) u vonua një ditë për në shtëpi. “Ç’të mbajti aq gjatë?” – e pyeti Aishja. Alejhisselami u përgjigj: “Këndimi i Kur'anit nga një njeri që e ka zërin më të mirë se cilido që njoh.” Atëherë ai u ngrit dhe e dëgjoji atë për ca kohë e pastaj tha: “Është Selimi, shërbëtori i Ebu Hudhejfes. Lavdi pastë Allahu për praninë e njerëzve të tillë në ummetin tim!”

Gjatë muajit të Ramazanit, Sufjan el-Theuri e kishte zakon t'i kushtojë këndimit të Kur'anit Fisnik dhe Malik ibn Enesi e kishte zakon ta ndërpriste studimin dhe hulumtimin e haditheve, duke ikur nga shoqëria e dijetarëve, që të përqendrohej në leximin e Kur'anit, siç tregon Zemakhsheri në ff. 257-8 të vëllimit të dytë të veprës së tij *Rabi'ul-Ebrar*.

Në një nga ligjëratat e tija, Imam 'Aliu ka thënë:

Askush nuk duhet të ankohet se i duhet diçka tjetër veç Kur'anit. Ai që privohet prej tij s'mund të quhet se ka, ndaj kërkoheni në të shërimin e lëngatës suaj dhe lutjani ndihmën kur të ndeshni vështirësi, pasi ai përmban ilaç për sëmundjet më të këqija: mosbesimin, hipokrizinë dhe devijimin. Përgjërojuni Allahut nëpërmjet atij në vend që t'i luteni cilësdo prej krijesave të Tij! Askush nuk mund ta kërkojë Allahun me diçka më të mirë se ai, dhe ta dini se ai është ndërmjetës që do të ndërmjetësojë për ju dhe një folës që flet të vërtetën. Për cilindo që ndërmjetëson

Kur'ani në Ditën e Gjykimit, ai do ta ketë atë ndërmjetësim dhe kushdo që synon t'ia dëshmojë vërtetësinë do të konsiderohet patjetër si burrë i hakkut, sepse në Ditën e Gjykimit do të thërritet: “Kushdo që kultivon sprovohet me çfarë ka kultivuar, përveç atij që kultivon Kur'anin”, ndaj jini mes kultivuesve e pasuesve të tij dhe bëjeni mjetin tuaj për tek Allahu. Kërkojeni këshillën e tij për shpirtrat tuaj dhe krahasojini qëndrimet tuaja me të tijat, e kërkojeni ndihmën kundër nënshtrimit ndaj dëshirave tuaja. (ez-Zemakhsheri, ff. 258-9)

Imami po ashtu ka thënë: “Ai që lexon Kur'an dhe, pasi vdes përfundon në Zjarr është nga ata që i kanë marrë shenjat e Allahut me të lehtë.”

SHPËRBLIMET E LEXIMIT TË SUREVE TË KUR'ANIT FISNIK

Shejh Taki ed-Din Ibrahim ibn 'Ali ibn el-Hasan ibn Muhammed ibn Salih el-'Amili el-Kaf'ami tregon se, lidhur me meritat e recitimit të Sureve dhe ajeteve të Kur'anit, Imam Sadiku ka thënë:

Kush reciton dhjetë ajete në një natë s' do shkruhet kurrë me mospërfillësit. Ai që reciton pesëdhjetë do të regjistrohet me shumëpërkujtuesit e Allahut (*dhakirîn*). Nëse këndon njëqind, do të regjistrohet me shumëpërgjëruesit e Allahut (*kunitîn*). Nëse reciton treqind, do të shkruhet me ngadhënjimtarët (*fa'izin*). Kush lexon pesëqind ajete, do të shkruhet me ata që përpiqen në rrugën e Zotit (*muxhtehidîn*). E nëse lexon njëmijë vargje, ai do të shpërblehet me një kantar që është pesëmijë mithkalë: çdo *mithkal* është sa njëzet e katër karatë, më i vogli prej të cilëve peshon [në vlerë] sa Mali i Uhudit, kurse më i madhi shtrihet nga toka deri në qiell. (*Misbah el-Kaf'ami*, vëll. II, f. 531)

Imami gjithashtu ka thënë, siç citohet po aty, që: “Nëse dikush reciton Kur'an, Allahu do t'ia bëjë të mundur shikimin e Tij [në zemër] dhe ai recitim ua zvogëlon dënimin prindërve të tij edhe po të jenë jobesimtarë.” Përfytyroni, lexues të nderuar, ç'efekt ka ai mbi prindërit që ju kanë rritur si muslimanë.

Bismilahi

Saherë që recitojmë një ajet nga Kur'ani i Shenjtë, ne fillojmë me *bismilah*, pra *Bismilahi'r-Rahmani'r-Rahim* (Në Emër të Allahut, të Gjithmëshirshmit, Plotmëshiruesit). Në Fatiha, suren e parë të Kur'anit Fisnik, Bismilahi është ajet në vetvete, kurse në suret e tjera, përveç et-Teubeh (el-Bara'eh) ku nuk recitohet, ajo shërben si hyrje për vargjet e tjera. Në faqet 39-40 të *Tefsir*-it të tij, el-Kummi transmeton një hadith me zinxhir të gjatë, i cili përfundon me Ebu Busejrin, që citon Imam Sadikun duke komentuar kuptimin e Bismilahit. Imami e shpjegon derivimin e secilës gërmë të bismilahit si më poshtë:

Ba-ja vjen nga *baha-Allah* (“Shkëlqimi i Allahut”); *sin*-i nga *sanna-Allah* (“Madhështia e Allahut”), *Allahu* është Zoti i gjithçkaje, *Rahmani* është ai mëshirshmi me të gjitha krijesat e Tij; *Rahimi* është Ai që e veçon besimtarin për shpërblimin më të madh nga mëshira e Tij.

Në faqen 506 të veprës *Misbah el-Kaf'ami*, i Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se kur mësuesi që i mëson fëmijës të lexojë Kur'an i thotë atij që të recitojë *Bismilahi'r-Rahmani'r-Rahim* dhe ai e reciton, Allahu e largon fëmijën, prindërit dhe mësuesin e tij nga xhehenemi; dhe se bismilahi përbëhet nga 19 gërma, sa ç'është dhe numri i portierëve të xhehenemit. Ndaj, këdo që e shqipton atë, Allahu do t'i lejojë këto letra t'i mbyllin dyert e xhehenemit për të.

Tani le të shohim se si qëndron puna me vlerën e secilës sure të Kur'anit të Shenjtë dhe çfarë shpërblimesh do të marrin besimtarët *insha-Allah* nga më Bujari për recitimim e tyre. Më poshtë vijon përkthimi nga shumica e tekstit origjinal në arabisht, të vëllimit II, ff. 506-42 nga vepra *Misbah el-Kaf'ami* e Shejh el-'Amili el-Kaf'amiut, krahas teksteve të zgjedhura nga vëllimi LXXXIX i *Bihar ul-Enuar* të 'Alame Mexhliut.

1. El-Fatiha

Në tefsirin e tij *Muxhma'ul-Bejan fi Tefsiri'l-Kur'an*, Tabarsiu jep dhjetë emra për suren e parë të Kur'anit Fisnik, Fatihanë: 1) *el-Fatiha*, ajo që hap, sepse është si portë, që kur hapet, çon tek Libri i Allahut; 2) *el-Hamd*, lavdërimi, sepse vargjet e saj e lavdërojnë qartë Fuqplotin; 3) *Umm ul-Kitab*, nëna e Librit, sepse pozita e saj është e epërme ndaj të gjitha sureve të Kur'anit të Shenjtë, ose si bajraku në luftë: qëndron gjithmonë në ballë; 4) *el-Seb'*, shtatështja, sepse përbëhet nga shtatë ajete duke qenë e vetmja me një numër të tillë vargjesh; 5) *el-Methani*, sureja e shumëpërsëritur, sepse asnjë sure tjetër nuk përsëritet sa kjo në Kur'an; 6) *el-Kafije*, mjaftuesja që nuk ka zëvendësuese, recitimim i saj thjesht nuk mund të zëvendësohet me asnjë tjetër në dy rekatet e para të namazit, ndërkohë që ajo mund të zëvendësojë të tjerat; 8) *el-Azas*, themeli, apo mbështetësja, çka nënkupton se ajo është baza ku mbështetet Kur'ani Fisnik, po ashtu siç është Bismilahi baza e Fatihasë; 9) *esh-Shifa'*, shërimi, sepse i Dërguari i Allahut (s) ka thënë se Fatihaja shëron nga të gjitha lëngatat, përveç vdekjes; 10) *es-Salat*, lutja, ose kërkesa bazë e namazeve ditore, pa këndimin e të cilës nuk mund të pranohet asnjë lutje, sidomos pasi i Dërguari i Allahut (s) ka treguar se në një hadith kuds, Allahu ka thënë: “Lutjet janë ndarë midis Meje dhe shërbëtorit Tim: gjysma për Mua, dhe gjysma tjetër për të” ndaj kur këndohet *el-hamdu li'l-Lahi Rabbi'l-'alemin*, Allahu Fuqplotë thotë: “Shërbëtori Im Më ka lavdëruar” dhe kur këndon *er-Rahmani'r-Rahim* i Gjithëfuqishmi thotë: “Robi Im Më ka madhëruar” e kur thotë *Maliki jeumi'd-din*, Allahu thotë: “Shërbëtori Im Më ka lartësuar.” Dhe, kur reciton *Ijjake na'budu ue Ijjake nesta'in*, Allahu do të thotë: “Ky është pakt midis Meje dhe robit Tim, atij do t'i plotësohen lutjet.” Atëherë, nëse e reciton Fatihanë deri në fund, Allahu do ta konfirmojë sërish premtimin e Vet, duke thënë: “Kjo është për shërbëtorin Tim dhe atij do t'i plotësohen dëshirat.”

I Dërguari i Allahut (s) citohet nga Ebu 'Ali el-Fadl ibn el-Hasan ibn el-Fadl et-Tabarsi, Allahu e mëshiroftë, duke thënë se ai që reciton Suren el-Fatiha do të konsiderohet nga Allahu si të kishte recituar dy të tretat e Kur'anit të Shenjtë dhe si t'i kishte dhënë sadaka' çdo besimtari dhe besimtareje. “Për Atë në dorën e të Cilit është shpirti im” vazhdon Pejgamberi (s), “Allahu Fuqplotë nuk ka shpalur në Teurat, Inxhil apo Zebur asnjë kaptinë si ajo, ajo është Nëna e Librit (Umm ul-Kitab) dhe Shtatëshja e Shumëpërsëritur (es-Seb' el-Methani) dhe ndahet midis Allahut e shërbëtorit të Tij, i cili do të marrë ç'të lypë; ajo është Sureja më e mirë në Librin e

më të Lartit dhe shërim për çdo lëngatë, përveç helmit – që është vdekja.” Resulullahi citohet gjithashtu nga el-Kaf’ami duke thënë: “Ai [Allahu] ma dhuroi si bekim të Vetin, duke e bërë të barazvlershëm me Kur’anin Fisnik, sepse Ai ka thënë: {E Ne të kemi dhënë es-Sab’ el-Methani dhe Kur’anin e Madh} [el-Hixhr: 87]. Ajo është më e çmuara prej thesareve të ‘Arshit.”

Vërtet, Allahu i Lartësuar ka zgjedhur vetëm Muhammedin (s) që të nderohet me të, pa ia dhënë këtë nder asnjë profeti ose të dërguari të Tij, përveç Sulejmanit (a.s) të cilit i është dhënë bismilahi (shih en-Neml: 30). Kush e reciton atë, duke qenë krejtësisht i bindur në ndjekjen e rrugës së Pejgamberit, duke iu përmbajtur urdhëresave të saj dhe duke besuar në kuptimet e saja të brendshme e të jashtme, do të shpërblehet nga Allahu për çdo gërmë të saj me një bekim që është më i mirë se gjithçka që ndodhet në botën e pasurisë dhe mirësive, ndërsa ai që e dëgjon dikë duke e recituar do të marrë një të tretën e shpërblimeve të recituesit.

2. el-Bekare

I Dërguari i Allahut (s) citohet nga Ubejji duke thënë: “Kush e reciton atë do fitojë bekime nga Allahu dhe mëshirën e Tij, do t’i jepen shpërblimet e atij që fushon për një vit në rrugën e Allahut, si ushtar në kufijtë e dar ul-Islamit për t’i mbrojtur ato, në vigjëlím të paprerë.” Pastaj i Dërguari i Allahut (s) iu kthye Ubejjit me fjalët: “O Ubejj! Urdhëroji muslimanët ta mësojnë, sepse mësimi i saj është bekim, kurse lënia e saj humbje, dhe s’ka magjistar që ta mposhtë!” Ai (s) gjithashtu citohet duke thënë se gjithçka ka një kulm, dhe kulmi i Kur’anit është Sureja el-Bekare. “Cili ajet në të është më i miri, o i Dërguari i Allahut?” e pyetën. Ai u përgjigj: “Ajeti Kursi [2:255]” Dhe ai ia besoi më të riut ndër sahabët e tij, Harith ibn Zejd ibn el-Harithes udhëheqjen e ushtrisë në mbrojtje të Islamit, në sajë të faktit se e dinte Suren el-Bekare përmendësh.

3. Al-i Imran

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se atij që e reciton atë do i jepet për çdo ajet siguri në urën e Siratit dhe kushdo që e reciton të premtëve do të bekohet nga Allahu dhe melekët e Tij tërë ditën gjer në aksham. Ai (s) citohet gjithashtu duke thënë: “Mësojeni përmendësh Suren el-Bekare dhe Al-i Imran, sepse ato janë si dy lule kundërmuese që Ditën e Gjykimit do ta marrin në hije atë që i mëson ato përmendësh, porsì dy re...” për t’i mbrojtur recituesit e saj nga nxehtësia e asaj Dite.

4. en-Nisa’

Pejgamberi i Bekuar (s) citohet duket thënë se ai që e reciton atë do të konsiderohet nga Allahu Fuqiplotë sikur të kishte qenë bamirës ndaj të gjithë jetimëve e do t’i dhurohen shpërblimet e atij që liron një person që largohet nga shirku dhe i cili, me vullnetin e Allahut, falet.” Imam ‘Aliu citohet duke thënë se kushdo që e reciton atë çdo të premtë do të jetë i siguruar nga ngushtimi i varrit.

5. el-Ma’ide

Imam 'Aliu citohet duke thënë se kush e reciton atë do të fitojë dhjetë shpërblime e dhjetë gjynahe do t'i falen, kurse pozita e tij do t'i rritet me dhjetë shkallë për çdo të krishterë dhe çifut të gjallë. Imam Sadiku thotë se ai që e reciton atë çdo të enjte mbrëma nuk do ta përziejë besimin e vet me asnjëfarë zullumi, e as nuk do të kryejë *shirk* ndonjëherë.

6. el-En'amë

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se kjo sure u shpall në tërësi e shoqëruar nga shtatëdhjetë mijë melekë që e madhëronin dhe lavdëronin Allahun në kor; ndaj, kushdo që e reciton do të bekohet nga po ata shtatëdhjetë mijë engjëj për një ditë e një natë të tërë. Imam Ridai citohet duke thënë se ata melekë do vazhdojnë ta bekojnë deri në Ditën e Gjykimit. I Dërguari i Allahut (s) ka thënë: “Kush e reciton atë nga fillimi deri në ajetin që thotë {Kështu i bëjmë disa zullumqarë të miqësojnë me të tjerë, për shkak të asaj që vepruan} [6:129], Allahu do t'i caktojë dyzet mijë engjëj për t'i shkruar [aq shpërblime sa] adhurimi i tyre deri në Ditën e Gjykimit. Sipas autorit të veprës *el-Efrad ue'l-Gharaib*, atij që e bën këtë pasi të ketë falur sabahun do t'i zbresin dyzet melekë dhe do t'i regjistrohet sa adhurimi i tyre. Sipas autorit të librit *el-Uasit*, nëse dikush e bën këtë recitim pasi të jetë zgjuar, Allahu do t'i caktojë njëmijë engjëj për ta mbrojtur dhe për t'i shkruar atij sa veprat e tyre [të adhurimit] deri në Ditën e Gjykimit.

7. el-A'rafë

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë që nëse dikush e reciton këtë sure, Allahu, Më i Larti, do të vendosë perde mbrojtëse mes tij dhe Iblisit, kurse Ademi (a.s.) do të kërkojë ndërmjetësim për atë në Ditën e Gjykimit. Imam Xha'fer es-Sadiku citohet duke thënë se ai që e lexon atë çdo muaj do të jetë mes atyre që nuk do të kenë frikë Ditën e Gjykimit e as nuk do brengosen; prandaj, nëse e lexon çdo të premte, ai do të jetë mes atyre që nuk do të sprovohen Ditën e Gjykimit.

8. el-Enfalë

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë: “Nëse dikush i reciton suret el-Enfalë dhe Bera'eh [Teube] së bashku, unë do të ndërmjetësoj dhe dëshmoj në Ditën e Gjykimit se ai është i lirë nga hipokrizia, dhe atij do t'i jepen shpërblime sa dhjetëfishi i numrit të hipokritëve dhe hipokriteve në botë e dhjetë gjynahe do t'i fshihen, kurse 'Arshi dhe ata [melekë] që e mbajnë atë do ta bekojnë për sa të jetë gjallë.” Imam Sadiku ka thënë: “Ai që reciton këto dy sure çdo muaj nuk do të kaplohet nga hipokrizia dhe do të jetë ndjekës i vërtetë i Prijësit të Besimtarëve dhe do të hajë me të në Ditën e Gjykimit nga tavolinat e Xhennetit, gjersa Allahu i Lartësuar të përfundojë gjykimin.”

9. Bera'eh

Meritat e saj janë të ngjashme me ato të sures el-Enfalë. Në një shënim lidhur me këtë sure, el-Kaf'ami shpjegon se “Bera'eh” (që dtth shkëputje, ndarje ose pastrim nga...) nënkupton shkëputje [të jobesimtarëve] nga 'Aliu; *Bismilahi* nuk është përfshirë në fillim të saj, siç ndodh me suret e tjera të Kur'anit Fisnik, thjesht pse *Bismilahi* shënon siguri e mëshirë, ndërsa Bera'eh u shpall që ta hiqte një siguri të tillë dhe të

paralajmëronte për konfrontim. El-Kaf'ami vazhdon e thotë se kjo sure ka dhjetë emra: 1) *Bera'eh*, sipas fjalës së parë në të; 2) *Teubeh*, për shkak të pendesës që përmend në tesktin e saj; 3) *Faziha*, shpallësja, treguesja apo njoftuesja, sepse zbulon dhe tregon të vërtetën duke njoftuar hipokrizinë e atyre munafikëve për të cilët flet; 4) *Muba'thire*, shpërhapës, sepse ua shpërhap dhe shpalos të gjithëve sekretet e fshehura të hipokritëve; 5) Mukashkishe, kuruese që shëron ose kuron besimtarët në të nga hipokrizia (*nifāk*) dhe politeizmi (*shirk*), falë lutjes dhe singëritetit që ajo përmban; 6) *Bahuth*, hetuese, hulumtuese, kërkuese sepse kërkon kurthet e fshehta të hipokritëve; 7) *Mudemdime*, shkatërruese, sepse dërrmon hipokrizinë dhe hipokritët; 8) *Hafire*, gërrmuese: ajo gërrmon në zemrat e hipokritëve dhe shpalos atë që fshehin; 9) *Mubashshire*, sihariqdhënëse: duke ua botëruar poshtërsitë dhe kurthet tinzare hipokritëve, ajo u sjell sihariqe atyre që nuk ishin në mesin e tyre; 10) *Edheb*, torturë, tmerr, për shkak të përmendjes së vazhduar të tmerrit që i pret hipokritët dhe të ngjashmit e tyre.

10. Junus

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se atij që reciton këtë sure do t'i jepen dhjetë shpërblime për çdo njeri që ka besuar në Junusin a.s. si dhe për ata që nuk i kanë besuar, që u mbytën me Faraonin. Imam Sadiku citohet duke thënë se kushdo që e reciton atë një herë në muaj nuk do të radhitet me të paditurit, por do të jetë me ata që janë pranë Allahut Ditën e Gjykimit.

11. Hudë

Pejgamberi (s) citohet duke thënë se kujt e reciton këtë sure do t'i dhurohen dhjetë shpërblime për çdo person që ka besuar në profetin Nuh (a.s.) dhe ata që nuk kanë besuar në atë e në profetët Hud, Salih, Shu'ajb, Lut, Ibrahim dhe Musa (paqe pastë mbi ata të gjithë) dhe në Ditën e Gjykimit do të jetë me të gëzuarit. Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë surë çdo të premte do të ringjallet në Ditën e Gjykimit me grupin që përfshin pejgamberët (paqe pastë mbi ta) dhe do të ketë sprovim të lehtë, ku nuk do t'i shënohet asnjë mëkat.

12. Jusuf

Për këtë sure, Imam Sadiku citohet të ketë thënë: “Le ta mësojnë shërbëtorët tuaj, sepse kushdo që ua mëson shërbëtorëve dhe atyre që i ka në dorën e djathtë do të ketë një vdekje të lehtë dhe do të fuqizohet aq sa të mos ia ketë zili asnjë muslimani.” Imami citohet gjithashtu duke thënë se ai që e reciton këtë sure çdo ditë dhe çdo natë do të ringjallet në Ditën e Gjykimit me bukuri të ngjashme me atë të Jusufit (a.s.) dhe nuk do të ndikohet nga tmerrri i madh i asaj dite, duke qenë në mesin e shërbëtorëve më të mirë të Allahut.

13. er-Ra'd

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të shpërblehet me mirësi sa numri i reve që kanë kaluar dhe do të kalojnë deri në Ditën e Gjykimit, kur do të jetë me ata që e kanë plotësuar betimin e tyre me Allahun. Imam Xha'fer es-Sadiku citohet gjithashtu duke thënë se ai që e reciton këtë sure mjaft

shpesh nuk do të goditet kurrë nga rrufeja dhe do të pranohet në Xhennet pa u marrë në pyetje duke fituar të drejtën për të ndërmjetësuar në emër të familjarëve dhe vëllezërve që njeh.

14. Ibrahim

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se personi që e reciton këtë sure do të shpërblehet me dhjetë sevabe për çdo njeri që ka adhuruar idhujt dhe çdo njeri që nuk i ka adhuruar ato. Imam Sadiku (a.s.) ka thënë gjithashtu se ai që e reciton edhe këtë sure edhe atë që i vijon në një namaz nafile prej dy rekatesh çdo të premtë nuk do të varfërohet e as nuk do të pësojë ndonjë fatkeqësi.

15. el-Hixhr

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të marrë dhjetë shpërblime për çdo muhaxhir dhe ensar dhe numrin e atyre që e kanë përqeshur Pejgamberin (s).

16. en-Nahl

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure nuk do të sprovohet nga Allahu për të mirat që i ka dhënë në jetën e kësaj bote e nëse vdes atë ditë ose natë, do të ketë shpërblimet e atij që vdes pasi ka lënë testament të mirë. Imami gjithashtu ka thënë se ai që e reciton suren një herë në muaj do të konsiderohet se i ka shlyer detyrimet e tij në këtë botë.

17. el-Isra'

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure dhe preket duke kujtuar prindërit e vet do të marrë shpërblime sa pesha e dy kantarëve. Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure çdo të premtë mbrëma nuk do të vdesë pa e parë el-Ka'imin (Mehdiun) dhe do të jetë mes mbështetësve të tij.

18. el-Kahf

Pejgamberi i Bekuar (s) citohet duke thënë se kushdo që e reciton Suren el-Kahf do të pranohet në Xhennet, dhe nëse e lexon të premtën, Allahu do t'ia falë gjynahet që ka bërë ose do të bëjë në dhjetë ditë, ku atij do t'i dhurohet një dritë që mbërrin qiejt duke e mbrojtur nga fitneja e Dexhhalit. Imam Sadiku ka thënë gjithashtu se kur është shpalur kjo sure, ajo është shoqëruar nga shtatëdhjetë mijë engjëj dhe madhështia e saj mbushi qiejt dhe tokën; kush e reciton atë përpara çdo xhumaje do të vdesë si *shehid* dhe do të ngjallet në shoqërinë e shehidëve.

19. Merjem

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se atij që e reciton këtë sure do t'i jepen shpërblime sa numri i atyre që kanë besuar në Zekerijjain (a.s.) dhe ata që nuk kanë besuar. Imam Sadiku ka thënë se kush e reciton shpesh nuk do të vdesë para se ai, pasuria dhe

fëmijët e tij të bekohen prej saj, dhe në Ditën e Gjykimit do të jetë mes mbështetësve të Isait a.s. e do t'i dhurohet në ahiret ajo që i ishte dhënë Sulejmanit në dynja.

20. Ta-Ha

Pejgamberi Fisnik (s) citohet duke thënë se atij që e reciton Suren Ta-Ha do t'i dhurohen shpërblime sa ato të muhaxhirëve dhe ensarëve, dhe se banorët e Xhennetit recitojnë vetëm dy sure: Ja-Sin dhe Ta-Ha, dhe se Allahu i ka recituar ato dymijë vjet përpara se të krijonte Ademin a.s. “Kurrë mos reshtni s’e kënduari” thoshte Imam Sadiku, “sepse Allahu i Lartësuar e do atë dhe ata që e këndojnë. Atij që e reciton atë do t'i jepet libri në dorën e djathtë pa u pyetur për veprat e tija dhe do t'i jepen shpërblime me të cilat do të kënaqet.”

21. el-Enbija'

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë: “Kush e reciton Suren el-Enbija' do të gjykohet nga Allahu me një gjykim të lehtë dhe çdo profet i përmendur në Kur'an do t'i shtërëngojë duart. Imam Sadiku ka thënë: “Ai që e reciton atë nga dashuria do të jetë në shoqërinë e pejgamberëve në Xhennet dhe do të respektohet së tepërmi në këtë dynja.”

22. el-Haxhxh

Pejgamberi i Bekuar (s) citohet duke thënë se atij që e reciton këtë sure do t'i jepen aq shpërblime (*sevabe*) sa numri i atyre që kanë kryer haxhxhin dhe 'umren. Imam Xha'fer es-Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton atë çdo tri ditë do ta kryejë haxhxhin në Shtëpinë e Zotit atë vit, dhe nëse vdes rrugës, do të hyjë në Xhennet.

23. el-Mu'minun

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se atij që e reciton këtë sure do t'i jepen sihariqe të mira nga melekët e Shpirtit, kundërmim dhe çfarëdo që i freskon sytë kur t'i zbresë engjëlli i vdekjes. Imam Sadiku citohet duke thënë që nëse dikush e reciton atë çdo të premtë, veprat e tija do të vulosen me lumturi dhe vendqëndrimi i tij do të jetë në kulmin më të lartë të Xhennetit me pejgamberët dhe të dërguarit.

24. en-Nūr

Pejgamberi Fisnik, paqe e bekime pastë mbi të dhe pasardhjen e tij, citohet duke thënë se atij që e reciton këtë sure do t'i jepen dhjetë shpërblime për numrin e të gjithë atyre që kanë besuar në të shkuarën dhe atyre që do të bësojnë në të ardhmen. Imam Sadiku gjithashtu ka thënë: “Forcojeni pasurinë, nderin dhe gratë e juaja me të!”

25. el-Furkan

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se atij që e këndon këtë sure çdo ditë ose çdo natë askush në familje nuk do t'i bëhet fajtor me zina, dhe kur të vdesë, shpirtin e tij do t'ia shoqërojnë shtatëdhjetë mijë engjëj që do të luten dhe kërkojnë faljen e Allahut për të gjersa të vendoset në varr, dhe ai do të hyjë në Xhennet pa u pyetur. Imam Kadhimi ka thënë: “Allahu nuk do ta torturojë askënd që reciton suren el-

Furkan çdo mbrëmje, e as nuk do ta sprovosh atë dhe vendqëndrimi i tij do të jetë në nivelin më të lartë të Xhennetit.”

26. el-Shu'ara'

Pejgamberi i Ndershëm (s) ka thënë: “Ai që e reciton Suren el-Shu'ara' do të marrë dhjetë shpërblime për numrin e të gjithë atyre që kanë besuar tek Nuhi a.s. dhe që nuk kanë besuar tek Hudi, Shu'ajbi, Salihu, Ibrahimimi dhe Isai, paqe pastë mbi ta, si dhe të gjithë ata që nuk besuan në Muhammedin s.a.” Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që reciton të gjitha Suret që fillojnë me Ta-Sin do të jetë mes shërbëtorëve të vërtetë të Allahut.

27. en-Neml

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të marrë dhjetë shpërblime për çdo njeri që ka besuar në Sulejmanin dhe që s'ka besuar në Hudin, Salihun, Shu'ajbin dhe Ibrahimin, paqe pastë mbi ta dhe se ai do të dalë nga varri duke thirrur: *La ilahe il-la'Llah*.

28. el-Kazās

Pejgamberi i Bekuar ka thënë se kujtdo që e reciton këtë sure Allahu do t'i japë dhjetë shpërblime për çdo besues dhe mosbesues në Musain a.s.

29. el-'Ankebut

Imam Sadiku ka thënë se “Ai që e reciton atë do të marrë dhjetë shpërblime (sevabe) për secilin jobesimtar.” Ai ka thënë gjithashtu: “Ai që reciton suret er-Rum dhe el-'Ankebut gjatë natës së njëzet e tretë të Ramazanit, për Allah, do të jetë me njerëzit e Xhennetit.”

30. er-Rum

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se atij që reciton Suren er-Rum do t'i dhurohen dhjetë shpërblime për çdo melek që lavdëron Allahun, nga qiejt dhe toka dhe do t'i kompensohet çfarëdo që të ketë humbur gjatë ditës ose natës, duke shtuar, sipas Kaf'amiut se: “Nuk bëj përjashtim për këtë e as nuk kam frikë se po hyj në gjynah, pasi këto sure kanë meritë të veçantë tek Allahu: el-'Ankebutë dhe er-Rum.”

31. Lukman

Profeti i Bekuar (s) citohet duke thënë se kushdo që e reciton këtë sure do të jetë në shoqërinë e Lukmanit në Ditën e Gjykimit dhe do të shpërblehet me dhjetë sevabe për çdo njeri që urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja. Ai gjithashtu ka thënë: “Kujt e reciton atë gjatë natës, Allahu Fuqiplotë do t'i caktojë tridhjetë melekë për ta mbrojtur nga Iblisi dhe ushtria e tij deri në mëngjes, dhe nëse e reciton gjatë ditës, ata do ta mbrojnë atë nga Iblisi dhe ushtria e tij deri në mbrëmje.”

32. es-Sexhdeh

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton Suren Lukman, Suren es-Sexhdeh dhe Suren el-Mulk do të konsiderohet si ta kishte kaluar tërë Natën e Kadrit duke adhuruar Fuqplotin. Imam Sadiku gjithashtu ka thënë: “Nëse lexohet të premtën mbrëma, Allahu i Lartësuar do t’ia japë librin e tij në dorën e djathtë dhe nuk do ta gjykojë për çfarë ka bërë [në dynja], dhe ai do të jetë në shoqërinë e Muhammedit, paqja dhe bekimet qofshin mbi të dhe pasardhjen e tij.”

33. el-Ahzabë

Profeti i Bekuar (s) citohet duke thënë për këtë sure se: “Atij që e reciton atë e ia mëson familjes dhe atyre që zotëron dora e tij e djathtë do t’i dhurohet siguri ndaj mundimit të varrit.” Imam Sadiku ka thënë se ai që e reciton atë shpesh do të jetë në Ditën e Gjykimit në fqinjësi të Pejgamberit (s).

34. Sebe’

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë: “Ditën e Gjykimit, çdo pejgamber do ta përshëndesë dhe t’i jetë shok atij që reciton Suren Sebe’.” Imam Sadiku ka thënë se ai që i reciton të dyja Suret Hamd të premtën mbrëma do të mbetet i mbrojtur nga Allahu dhe po kështu edhe pasuria e tij, gjatë jetës së tij, dhe ai nuk do të pësojë asgjë të keqe dhe do t’i jepet nga jeta më e mirë në këtë botë dhe në ahiret, aq sa asnjë zemër nuk do të dëshirojë më shumë, sado e vështirë të jetë për t’u kënaqur.

35. Fatir

Pejgamberi Fisnik (s) ka thënë se ai që e reciton Suren Fatir për kënaqësinë e Allahut do të thërritet nga të tetë dyert e Xhennetit për të hyrë nga cilado që dëshiron.

36. Ja-Sin

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë: “Kushdo që hyn në një varrezë dhe reciton Suren el-Jasin do t’ua ketë pakësuar vuajtjen [të vdekurve] dhe do të marrë shpërblime sa numri i të varrosurve aty.” Ai gjithashtu ka thënë se në Teurat ajo përshkruhet si Sureja që e stolis recituesin me më të mirat e dynjasë dhe ahiretit, duke ia larguar sprovat e kësaj jete dhe tmerrin e asaj që vjen. Imam Xha’fer es-Sadiku citohet duke thënë se kushdo që e reciton këtë sure duke synuar kënaqësinë e Allahut do të falet dhe do t’i jepen shpërblimet e atij që ka recituar krejt Kur’anin dymbëdhjetë herë. Ai po ashtu ka thënë: “Për gjithçka ka një zemër, dhe zemra e Kur’anit është Ja-Sini; ndaj, ai që e reciton atë gjatë ditës do të mbrohet dhe furnizohet deri në mbrëmje.”

37. es-Saffāt

Ahmed ibn Idrisi citon el-Esh’ariun që përcjell nga Muhammed ibn Hasani, i cili citon el-Batainiun që transmeton nga Ibn el-‘Alaja se Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë që ai që e reciton këtë sure të premtën do të mbrohet nga të gjitha të këqijat e botës të ndeshura në këtë jetë, me furnizimin më bujar, dhe Allahu nuk do ta lërë pasurinë, fëmijët, ose trupin e tij të lëndohet nga ligësia e asnjë shejtani. Për më tepër, nëse ndërron jetë atë ditë ose natë, ai do të vdesë si shehid dhe do të pranohet në Xhennet

në shoqërinë e shehidëve, duke qëndruar me ta në Parajsë. Në faqen 419 të veprës *Mekarim ul-Akhlak* nga Tabarsiu, Imami citohet duke thënë se kjo sure këndohet nga ata që synojnë dinjitet në këtë jetë dhe në atë që vjen. E njëjta pohohet në vëll. LXXXIX, f. 296 të veprës *Bihar ul-enuar* të ‘Alame Mexhlesiut. Janë vërtet me fat ata që e recitojnë këtë sure të lavdishme të Kur’anit Fisnik në vazhdimësi sepse do të nderohen në dynja dhe në ahiret. Allahu Te’ala na bëftë me ta, *Amin*.

38. Sa’d

Ibn el-Batani e gjurmon zinxhirin e hadithit të mëposhtëm tek ‘Amr ibn Xhubejri, që citon të atin duke transmetuar nga Imam Bakiri se: “Atij që reciton Suren Sa’d të premtën mbrëma, do t’i jepet nga jeta e mirë në këtë botë dhe në ahiret ajo që s’do t’i jepet askujt përveç një të dërguari-profet ose një meleku pranë Allahut, dhe Allahu do ta pranojë në Xhennet bashkë me të gjithë anëtarët e familjes që ai i do, përfshi shërbëtorin ose dikë tjetër.”

39. ez-Zumer

Në faqe 102 të veprës *Thewab ul-A’mal* tregohen shpërblimet e fatlumëve që janë bekuar me recitim të kësaj sureje. Ibn el-Batani citon Sendelin duke përcjellë nga Harun ibn Kharixhe që transmeton nga Ebu ‘Abdullah Imam Xha’fer es-Sadik se:

Atij që e memorizon këtë sure do t’i jepet nga Allahu dinjitet në këtë jetë dhe në atë që vjen; do të nderohet edhe po të mos ketë pasuri apo shumë pasardhës, e të gjithë do të mahniten me të; Ai do t’ia ndalojë Xhehenemit prekjen e tij dhe do t’i ndërtojë në Xhennet njëmijë qytete, në çdonjërin nga të cilët do të ketë njëmijë pallate e në secilin prej tyre janë njëqind hyri. Përpos kësaj, ai do të ketë dy burime dhe dy lumenj si dhe dy të tjera në dy kopshte me bimësi të gjelbër dhe hyri të tjera në pavijone, me shikimet e tyre vetëm drejt tij, dhe ai do të ketë dy fruta nga secila pemë [e Xhennetit].

40. el-Mu’min

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë: “Shpirtrat e çdo pejgamberi, siddiku dhe besimtari do ta bekojnë dhe lusin falje për atë që e lexon këtë sure.” Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë se Allahu do t’ia falë të gjitha mëkatet atij që e reciton atë çdo tri net dhe se do ta bëjë t’i përmbahet fjalës së drejtë, kurse ahiretin më të mirë se dynjanë.

41. Fussilet

Pejgamberi i Ndershëm (s) ka thënë: “Atij që e reciton këtë sure do t’i jepen dhjetë shpërblime për çdo shkronjë në të.” Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë se ajo do t’i jetë dritë në Ditën e Gjykimit sa të shohin sytë e tij dhe burim gëzimi, kurse në dynja do të jetojë i lavdëruar, i shumëpëlqyer.

42. esh-Shura

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se: “Kush e reciton Suren el-Shura do të jetë mes atyre që bekoen nga melekët dhe për të cilët ata lusin faljen dhe mëshirën e

Allahut.” Imam Sadiku ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të ringjallet në Ditën e Gjykimit me fytyrë si hëna e plotë.

43. el-Zuhrufë

Profeti i Bekuar (s) citohet duke thënë se ai që e këndon këtë sure do të jetë në Ditën e Gjykimit me ata të cilëve Allahu do t’u drejtohet kështu: “O shërbëtorët e Mi! Nuk ka frikë për ju në këtë Ditë, e as pikëllim.” Imam Xha’fer es-Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton atë shpesh do të ketë siguri në varr nga nga Allahu, ndaj çdo lëndimi dhe ndaj ngushtimit të varrit, gjersa të dalë përpara Allahut Te’ala, dhe do të jetë kjo sure ajo që do ta fusë në Xhennet.

44. el-Dukhan

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure të premtën mbrëma do të falet dhe për çdo ajet do të marrë shpërblimet e atij që liron njëqind mijë skllëvër, ku shtatëdhjetë mijë engjëj do të kërkojnë falje për të; dhe Allahu do të ndërtojë një pallat për atë që e lexon të premtëve. Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë se ai që e lexon atë sure në namazet e detyrueshme dhe të pëlqyeshme do të ngjallet me ata që do të jenë të sigurtë dhe Allahu do ta mbulojë me hijen e ‘Arshit të Tij dhe do ta sprovë me një sprovë të lehtë, duke ia dhënë librin [e veprave] në dorën e djathtë.

45. el-Xhathije

Pejgamberi Muhammed (s) ka thënë për këtë sure se: “Gabimet e atij që e lexon atë do të mbulohen nga Allahu, i Cili do t’ia largojë frikën kur të dalë për t’u gjykuar.” Imam Sadiku ka thënë se ai që e reciton atë nuk do ta shohë zjarrin kurrë dhe do të jetë në shoqërinë e Muhammedit (s).”

46. el-Ahkafë

Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë: “Ai që e reciton atë do të marrë dhjetë shpërblime për çdo grimcë rëre në botë.” Ai gjithashtu ka thënë: “Kush e reciton atë çdo natë nuk do të ekspozohet nga Allahu para asnjë frike në këtë jetë dhe do të sigurohet nga tmerri i Ditës së Gjykimit.”

47. Muhammed

Imam Sadiku citohet duke thënë se në qoftë se dikush e reciton këtë sure, Allahu i Lavdëruar do ta marrë përsipër t’i lejojë të pijë nga lumenjtë e Xhennetit dhe se dyshimi nuk do të hyjë asnjëherë në mendjen e tij.

48. el-Fet’h

Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të jetë si ai që ka qenë i pranishëm kur Profeti (s) çliroi Mekën dhe ai ai që i ka dhënë besën nën pemë. Imami gjithashtu ka thënë për këtë sure: “Forconi me të shëndetin, gratë dhe çfarë ju zotëron dora e djathtë, kundër çdo dëmtimi.”

49. el-Huxhuratë

Imam Xha'fer es-Sadiku ka thënë se atij që e reciton këtë Sure do t'i jepen shpërblime për çdo njeri që i është bindur Allahut dhe çdo njeri që nuk i është bindur Atij. Imami gjithashtu ka thënë: “Ai që e lexon atë çdo natë ose çdo ditë do të jetë me ata që do ta vizitojnë Profetin (s).”

50. Kaf

Pejgamberi Muhammed (s) ka thënë për këtë sure se: “Atij që e lexon këtë sure shpesh, Allahu do t'ia lehtësojë vuajtjen e vdekjes.” Dhe “ai që e reciton atë në namazet e detyrueshme dhe ato nafile do të ketë rritje të furnizimit nga Allahu Te'ala dhe Ai do t'ia japë librin në dorën e djathtë, pasi ta ketë gjykuar me një gjykim të lehtë.”

51. edh-Dharijatë

Imam Xha'fer es-Sadiku ka thënë: “Ai që e reciton atë do të marrë dhjetë vepra të mira për çdo erë që ka fryrë në jetën e kësaj bote” dhe se ai që e reciton gjatë ditës ose natës do të ketë lehtësim të jetesës.

52. et-Turë

Imam Sadiku citohet gjithashtu duke thënë se atij që e reciton këtë sure Allahu do t'i dhurojë siguri nga tmerri i Tij dhe do ta lejojë të shijojë Xhennetin e Tij. Ai po ashtu ka thënë se kushdo që e reciton atë do të ketë më të mirën e dy botëve.

53. en-Nexhm

Imam Sadiku citohet duke thënë se atij që e reciton këtë sure do t'i jepen dhjetë shpërblime për çdo njeri që ka besuar në Pejgamberin (s) dhe çdo njeri që nuk i ka besuar. Dhe, ai që e reciton atë shpesh do të jetojë mes njerezve i lëvduar, i dashur.

54. el-Kamar

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se kushdo që e reciton këtë sure çdo dy ditë do të ringjallet me fytyrën e tij si hënë e plotë. Kurse Imam Sadiku ka thënë: “Ai që e reciton atë do të ngrihet nga varri i mbartur me një deve nga devetë e Xhennetit.”

55. er-Rahman

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë për këtë sure se: “Atë që e lexon këtë sure, Allahu do ta mëshirojë në dobësi dhe ai do të konsiderohet falënderues i Allahut për këtë.” Imami Sadiku citohet duke thënë se ka një nuse për të gjithë, dhe nusja e Kur'anit është Sureja er-Rahman dhe se Allahu do t'ia ndriçojë fytyrën gjithkujt që e reciton atë shpesh.

56. el-Uaki'e

Imam Sadiku ka thënë: “Kushdo që e reciton atë nuk do të shkruhet me të pavëmendshmit, kurse ai që e reciton të premtëve mbrëma do të duhet nga Allahu.”

57. el-Hadid

Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të shkruhet me ata që kanë besuar në Allahun dhe të Dërguarin e Tij (s) në mënyrë të patundur. Imami gjithashtu ka thënë se: “Ai që i reciton të gjitha suret që fillojnë me lavdërimin e Allahut [el-Hadidë, el-Hashr, es-Saff, el-Xhum’a dhe et-Teghabunë] përpara se të bjerë të flejë nuk do të vdesë pa e takuar el-Ka’imin [Mehdiun]; dhe nëse vdes, do të jetë fqj i Profetit (s).”

58. el-Muxhadileh

Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të shkruhet me palën e Allahut, që do të jenë ngadhënjimtarë në Ditën e Gjykimit. Imami gjithashtu ka thënë se: “Ai që e reciton Suren el-Hadidë dhe el-Muxhadile në namazet e detyrueshme dhe vazhdon në të, nuk do t’i ekspozohet asnjë vështirësie nga Allahu për sa të jetë gjallë.”

59. el-Hashr

Imam Sadiku ka thënë se kushdo që reciton Suren el-Hashr do të bekohet nga Allahu, i Cili do t’ia marrë shpirtin si të ishte shëhid dhe Xhenneti, Xhehenemi, ‘Arshi e Kursija do të lusin falje për të, dhe se atij që reciton ç’të mundet nga Sureja er-Rahman dhe Sureja el-Hashr gjatë natës, Allahu do t’i caktojë një engjëll mbrojtës deri në agim.

60. el-Mumtahine

El-Kaf’ami citon Profetin e Islamit (s) duke thënë për këtë sure se: “Ai që e lexon atë do të marrë ndërmjetësimin e të gjithë besimtarëve dhe besimtareve në Ditën e Gjykimit.” ‘Alame Mexhliu dhe Ibn el-Bataini transmetojnë një thënie nga Imam Zejnul-‘Abidini që tregon se: “Ai që e lexon këtë Sure në namazet e tija të detyrueshme dhe vullnetare do jetë vulosur nga Allahu si dikush me bindje të plotë dhe Ai do t’ia mbushë zemrën me dritë, e as varfëria as çmenduria nuk do ta prekin atë dhe pasardhësit e tij ndonjëherë.”

61. es-Saff

I Dërguari i Allahut (s) citohet në f. 520 të veprës *el-Misbah nga el-Kaf’ami* duke thënë: “Për atë që e reciton atë, Isai do të lutet dhe kërkojë falje për sa kohë të jetë në këtë botë dhe do t’i jetë shok në Ditën e Gjykimit.” Imam Sadiku ka thënë se nëse dikush e reciton atë shpesh në namazet e detyrueshme dhe ato vullnetare, Allahu do të vendosë atë në rangjet e melekëve, profetëve dhe të dërguarve të Tij.

62. el-Xhum’a

Pejgamberi Fisnik (s) ka thënë: “Atij që e reciton këtë sure do t’i jepen dhjetë shpërblime për çdo njeri që ka ndjekur dhe çdo njeri që nuk i ka ndjekur xhumatë në të gjitha tokat islame.” Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë: “Çdo besimtar dhe çdo besimtare, nëse është ndër ndjekësit tanë, duhet të recitojë të premtën mbrëma Suren el-Xhum’a dhe Suren el-A’la, kurse në namazin e drekës duhet të recitojnë Suren el-Xhum’a dhe el-Munafikun; e nëse vepron kështu ai do të llogaritet si ndjekës i gjurmëve të Profetit (s) dhe shpërblim i tij nga Allahu do të jetë Xhenneti.

63. el-Munafikun

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se ai që e reciton këtë Sure do të pastrohet nga dyshimi dhe hipokrizia në lidhje më besimin.

64. et-Teghabunë

El-Kaf’ami dhe el-Mexhlisi tregojnë se Ibn el-Bataini citon Ibn Abdu’l-‘Alain që transmeton nga Ebu Busejri se Imam Ebu ‘Abdullah Xha’fer es-Sadiku ka thënë se atij që e reciton këtë sure në namazet e tija të detyrueshme dhe vullnetare, ajo do t’i ndërmjetësojë në Ditën e Gjykimit dhe do t’i jetë dëshmues i sigurtë përpara Atij që do t’ia lejojë të dëshmojë, pa u ndarë prej tij gjersa ta shoqërojë në Xhennet.

65. et-Talak

I Dërguari i Allahut (s) citohet nga Kafamiu dhe ‘Alame Mexhlisiu, si dhe nga autori i veprës *ed-Durr ul-Menthur*, vëll. VI, f. 107, se kushdo që e reciton këtë Sure do të vdesë si zbatues i Sunnetit të Profetit (s). Imam Xha’fer es-Sadiku (s) citohet duke thënë se nëse e reciton atë bashkë me Suren et-Tahrimë në namazet e detyrueshme, ai do të strehohet nga frika, hidhërimi dhe zjarri në Ditën e Gjykimit.

66. et-Tahrimë

Profeti i Bekuar (s) ka thënë se atij që e reciton këtë Sure do t’i jepet një pendim i vërtetë nga Allahu Subhanehu ue Te’ala. Si ‘Alame Mexhlisiu, ashtu edhe Tabarsiu tregojnë se shpërblimet e recitimit të kësaj sureje janë si ato të këndimit të Sures et-Talak, çka mbështetet edhe nga Kaf’amiu.

67. el-Mulk

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë për këtë sure se: “Ai që e reciton do të konsiderohet si ai që ka qëndruar zgjuar gjatë Natës së Kadrit duke adhuruar Zotin e vet. Ajo do ta mbrojë dhe shpëtojë atë që e reciton, nga ngushtimi i varrit.” Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë: “Këmbët e atij që e reciton këtë sure çdo ditë dhe çdo natë do t’u thonë Munkirit dhe Nakirit: ‘nuk keni të drejtë kalimi’.” Tabarsiu tregon se ajo i jep recituesit të saj siguri deri sa të hyjë në Xhennet.

68. el-Kalem

Pejgamberi i Zotit (s) ka thënë se: “Atij që e reciton këtë sure do t’i jepen shpërblimet e atyre që sillen virtutshëm.” Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë: “Kushdo që e reciton

në namazet e detyrueshme ose vullnetare nuk do të vuajë kurrë nga varfëria dhe Allahu do t'i japë siguri nga ngushtimi i varrit.”

69. el-Hakkah

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të ketë gjykim të lehtë në Ditën e Kijametit. “Recitoheni atë shpesh” i udhëzonte Imam Sadiku ndjekësit e tij “në namazet e detyrueshme dhe në vullnetaret, sepse kjo është shenjë e besimit në Allah dhe të Dërguarin e Tij (s), e kushdo që e reciton atë s’do të devijojë kurrë nga besimi i drejtë deri sa të vdesë.”

70. el-Me’arixh

Pejgamberi Fisnik (s) citohet duke thënë se atij që e reciton këtë Sure do t’i jepen shpërblimet e atyre që i mbajnë premtimet dhe amanetet e të cilët e falin namazin pareshtur.” Kurse Imam Sadiku pohonte: “Ai që e vazhdon recitimën e saj nuk do të pyetet në Ditën e Gjykimit për asnjë mëkat që ka kryer dhe Allahu do ta pranojë në Xhennetin e Tij në shoqërinë e Muhammedit, paqe dhe bekime pastë mbi të dhe pasardhjen e tij.

71. Nuh

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të numërohet me ata besimtarë që përfshihen në du’anë e Nuhit dhe se kush beson në Allah dhe Librin e Tij nuk duhet të reshtë kurrë s’e recituari. Në faqe 108 të veprës *Thewab ul-A’mal* citohet një pohim nga Imam Ebu ‘Abdullah Xha’fer es-Sadiku, që thotë: “Kush beson në Allah dhe lexon Librin e Tij nuk duhet të pushojë s’e recituari Suren Nuh, sepse çdo rob që e lexon atë me durim në një namaz të detyrueshëm ose vullnetar, Allahu Te’ala do ta lejojë të qëndrojë me ata që i janë bindur vërtetësisht Atij e do t’i dhurojë tre kopshte, krahas nderimit dhe martesës me njëqind hyri dhe katër mijë të tjera që s’janë prekur nga askush më parë, *insha Allah.*” Kjo transmetohet edhe në veprën *Bihar ul-Enuar* të ‘Alame Mexhlesiut.

72. el-Xhinn

Pejgamberi i Zotit (s) ka thënë për këtë sure se: “Atij që e reciton atë do t’i jepen shpërblime sa numri i të gjithë xhinëve dhe shejtanëve që kanë besuar ose nuk kanë besuar në Muhammedin.” Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë: “Ai që e reciton këtë sure mjaft shpesh nuk do të ketë kurrfarë lëndimi nga magjia dhe fitneja e xhinëve dhe ai do t’i bashkohet shoqërisë së Muhammedit (s).”

73. el-Muzzemmil

I Dërguari i Allahut (s) citohet nga Kaf’amiu duke thënë se ai që e reciton këtë sure nuk do të vuajë prej halleve në këtë jetë e as në atë që vjen. Imam Sadiku ka thënë: “Ai që e reciton atë do të ketë larguar hallet nga jeta e tij si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën. Kush e reciton atë në jaci ose në pjesën e fundit të natës do t’i ketë atë ditë dhe natë bashkë me këtë sure si dëshmitare dhe Allahu do t’i japë jetë të mirë dhe do t’ia marrë shpirtin me bukuri.”

74. el-Muddeththir

Pejgamberi i Zotit (s) citohet duke thënë se personit që e reciton këtë sure do t'i dhurohen shpërblime sa numri i atyre që i kanë besuar dhe s'i kanë besuar të Dërguarit (s) në Mekë. Pasardhësi i tij, Imam Xha'fer es-Sadiku citohet duke thënë që: “Nëse dikush e reciton atë në namazet e detyrueshme, Allahu – Më i Larti do ta marrë përsipër ta vendosë në shoqërinë e Profetit (s) dhe ai nuk do të vuajë aspak nga mjerimi në këtë botë.”

75. el-Kijame

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë në lidhje me lexuesin e kësaj sureje se: “Atij që e reciton atë, unë dhe Xhibra'ili do t'i dëshmojmë në Ditën e Gjykimit se ka qenë ndër besimtarët në Ditën e Kijametit dhe fytyra e tij do të dallohet mes të tjerave.” Imam Sadiku citohet duke thënë se: “Atij që e reciton këtë Sure dhe vepron sipas saj, Allahu do t'ia dërgojë atë në mënyrën më të mirë për t'ia dhënë atij sihariqet dhe për të buzëqeshur, e ai nuk do të ketë telashe për të kaluar Siratin dhe Mizanin.”

76. ed-Dahr

Pejgamberi i Ndershëm (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të shpërblehet me Xhennet dhe rroba mëndafshi. Imam Xha'fer es-Sadiku ka thënë: “Atij që e reciton atë një të enjte do t'i jepen nga Allahu njëqind hyri symëdha dhe ai do të jetë në shoqëri me Profetin (s).”

77. el-Murselat

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë që nëse dikush e reciton këtë sure, atij do t'i shkruhet se nuk është nga mesi i politeistëve (*mushrikin*). Imam Sadiku ka thënë për këtë kaptinë të Kur'anit se: “Atë që e lexon këtë sure, Allahu do ta prezantojë me Pejgamberin, paqe e bekime pastë mbi të dhe pasardhjen e tij.”

78. en-Nebe'

Profeti i Bekuar (s) ka thënë se atij që e reciton këtë sure, Allahu do t'i japë pije të freskët në Ditën e Gjykimit. Imam Xha'fer es-Sadiku ka thënë: “Kushdo që e reciton atë përditë do ta vizitojë Qa'ben pa u mbushur viti.”

79. en-Nazi'at

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se kushdo që e reciton këtë Sure nuk do të gjykohet për shumë gjatë në Ditën e Kijametit, por aq sa zgjat një namaz i detyrueshëm. Imam Sadiku citohet duke thënë: “Ai që e reciton do të vdesë i freskuar (pa etje), do të ringjallet i freskuar dhe do të hyjë në Xhennet i freskuar.”

80. Abese

Pejgamberi Fisnik (s) citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të vijë në Ditën e Gjykimit i qeshur, optimist. Imam Xha'fer es-Sadiku citohet gjithashtu duke thënë se ai që e reciton këtë sure si dhe suren Takuir do të strehohet tek hija dhe begatia e Allahut në Xhennetin e Tij.

81. et-Tekuir

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e lexon këtë sure nuk do të ekspozohet nga Allahu kur të shpalosen librat e veprave dhe se “kushdo që dëshiron të më shohë në Ditën e Gjykimit, le të lexojë këtë sure.”

82. el-Infitar

Profeti i Bekuar (s) ka thënë që nëse dikush e reciton atë, Allahu do t'i shkruajë një shpërblim për çdo pikë shiu e çdo varr dhe do t'ia përmirësojë gjendjen në Ditën e Gjykimit. Imam Sadiku citohet duke thënë për këtë sure se: “Atë që e lexon Suren el-Infitar dhe Suren el-Inshikak, duke i mbajtur parasysh vazhdimisht, në namaze të detyrueshme dhe vullnetare, nuk do ta mbulojë asnjë perde nga Allahu Te'ala dhe i Lartmadhëruari do të kujdeset për të gjersa të tjerët të kenë përfunduar së dhëni llogari.”

83. el-Mutaffifin

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë që nëse dikush e reciton këtë sure, Allahu do t'i lejojë të pijë nga një nektar i vulosur në Ditën e Gjykimit. Imam Sadiku citohet duke thënë se: “Atij që e bën shprehi ta recitojë këtë sure në namazet e detyrueshme, Allahu do t'i japë siguri nga zjarri dhe llogaridhënia, dhe ai nuk do të kalojë përmbi urën e xhehenemit.”

84. el-Inshikak

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë se atij që e reciton këtë sure nuk do t'i jepet kurrsesi nga prapa libri i veprave të tij.

85. el-Buruxhë

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se personit që e reciton këtë sure do t'i dhurohen dhjetë shpërblime për çdo të premtë dhe ditë 'Arafati në jetën e tij në këtë botë, kurse Imam Sadiku ka thënë se: “Ai që e lexon këtë sure në namazin e detyrueshëm do të mblidhet me profetët e Allahut [në Ditën e Gjykimit] sepse ajo është sureja e tyre.”

86. et-Tarik

Profeti Fisnik (s) ka thënë që nëse dikush e reciton këtë Sure, atij do t'i jepen dhjetë shpërblime për çdo yll në qiell, kurse Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure në namazet e detyrueshme do të arrijë pozitë të veçantë tek Allahu, dhe do të jetë në Xhennet me shoqëruesit e profetëve.

87. el-A'la

I Dërguari i Allahut citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të marrë dhjetë shpërblime për çdo gërmë të shpalljes së Allahut për Ibrahimin, Musain dhe Isain (paqe pastë mbi ta) dhe Muhammedin (paqe e bekime pastë mbi të dhe familjen e tij). Imam Xha'fer es-Sadiku citohet duke thënë që nëse dikush e reciton atë në namazet e detyrueshme ose vullnetare, atij do t'i thuhet në Ditën e Gjykimit: “Hyr në Xhennet nga cila derë të dëshirosh!”

88. el-Ghashije

Pejgamberi i Zotit (s) ka thënë se kushdo që e këndon atë do të ketë gjykim shumë të lehtë. Imam Sadiku ka thënë: “Kushdo që e reciton atë vazhdimisht në namazet e detyrueshme dhe vullnetare do të përfshihet në mëshirën e Allahut në këtë botë dhe atë që vjen, dhe Ai do t'i japë siguri nga ndëshkimi i Tij.”

89. el-Faxhr

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure për dhjetë netë rresht do të falet nga Allahu, dhe nëse e reciton ditën, ajo do t'i jetë dritë Ditën e Gjykimit. Imam Sadiku ka thënë gjithashtu se: “Ai që e lexon këtë sure në namazet e detyrueshme dhe vullnetare do të jetë në Xhennet në të njëjtin rang me Imam Huseinin, sepse ajo është sureja e Huseinit.”

90. el-Beled

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se kushdo që e reciton këtë sure do të jetë i sigurtë në Ditën e Gjykimit nga zemërimi i Allahut. Po ashtu, Imam Sadiku ka thënë se: “Ai që e reciton këtë sure në namazet e tij të detyrueshme dhe vullnetare do të njihet në jetën e kësaj bote si një nga të drejtët.”

91. esh-Shems

Profeti i Bekuar (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të mbahet si ai që i ka dhënë *sadaka* çdo njeriu nën diell dhe nën hënë. Imam Xha'fer es-Sadiku citohet duke thënë se në favor të atij që e lexon mjaft shpesh këtë sure, si dhe suret el-Lejl, el-Duha dhe el-Inshirah, do të dëshmojë gjithçka në Ditën e Gjykimit, përfshi flokët, fytyrën, mishin, gjakun dhe venat e tij.

92. el-Lejl

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se atij që e reciton këtë sure do t'i jepen [mirësi] derisa të kënaqet dhe Allahu nuk do ta lërë t'u ekspozohet vështirësive, duke ia lehtësuar jetën.

93. ed-Duha

Pejgamberi Fisnik (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të jetë me ata që janë pranuar nga Allahu si pjesëtarë të ummetit të Muhammedit (s) që janë të denjë për ndërmjetësimin e tij dhe do të marrë dhjetë shpërblime për çdo jetim dhe lypës.

94. el-Inshirah

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se kujt do që e reciton këtë sure do t'i jepen shpërblime sikur ta kishte takuar Profetin (s) të pikëlluar dhe t'ia kishte hequr atij pikëllimin.

95. et-Tinë

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se Allahu do t'i japë dy shpërblime kujt do që e reciton këtë sure: shëndet të mirë dhe bindje për sa të jetë gjallë, dhe kur të vdesë, Allahu Fuqplotë do t'i japë shpërblimet e agjërimit të të gjithë atyre që e kanë recituar. Kurse Imam Xha'fer es-Sadiku citohet të ketë thënë: “Atij që e lexon në namazet e tija të detyrueshme dhe vullnetare do t'i jepet ç't'i pëlqejë nga Xhenneti.”

96. el-'Alak

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë se kushdo që e reciton këtë sure do të llogaritet sikur ta ketë lexuar krejt Kur'anin. Imam Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure dhe vdes atë ditë ose atë natë do të ketë vdekur si shehid dhe si dikush që e ka ndihmuar Profetin (s) me shpatën e tij.

97. el-Kadr

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të konsiderohet nga Allahu si ai që ka agjëruar muajin e Ramazanit dhe e ka kaluar natën e Kadrit në adhurim të Krijuesit të vet. Imam Sadiku citohet duke thënë se atij që e lexon këtë sure në një namaz të detyrueshëm do t'i thuhet: “O shërbëtor i Allahut! Gjynahet e kaluara të janë falur, ndaj vazhdoji veprat e mira!” Imami gjithashtu ka thënë: “Kushdo që e reciton atë me zë do të jetë si ai që e ka ngritur shpatën në shërbim të Islamit, dhe nëse e reciton pa zë do të llogaritet si shehid në rrugën e Islamit, kurse po ta lexojë dhjetë herë, do t'i falen një mijë mëkate.”

98. el-Bejjine

Profeti Fisnik (s) ka thënë se ai që e reciton atë do të mblidhet Ditën e Gjykimit me më të mirët e krijimit në vend dhe kushte. Ai gjithashtu ka thënë: “Sikur ta dinin njerëzit se çfarë meritash përmban ajo, do t'i linin familjet e tyre dhe pasurinë mënjane për ta mësuar.” Imam Sadiku ka thënë se ai që e reciton këtë sure do të jetë i lirë nga shirku e do të pranohet në besimin e Profetit (s) dhe Allahu do t'i japë gjykim të lehtë.

99. el-Zelzele

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë: “Kushdo që e reciton këtë sure do të konsiderohet sikur të ketë lexuar Suren el-Bekare dhe do të marrë shpërblimet si të kishte lexuar një të katërtën e Kur'anit.” Imam Xha'fer es-Sadiku ka thënë për këtë sure se: “Ai që e lexon në namazet vullnetare nuk do të kaplohet kurrë me tërmet, rufe ose fatkeqësi tjetër natyrore, dhe nëse vdes, Zoti i tij do të urdhërojë pranimin e tij në Xhennet.”

100. el-‘Adijat

Profeti i Bekuar (s) ka thënë se atij që e reciton këtë sure do t’i jepen dhjetë shpërblime për çdo njeri që ka kaluar natën në Muzdelife [gjatë haxhxit] dhe ka ndjekur grumbullimin e madh [në ‘Arafat]. Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë: “Ai që e reciton mjaft shpesh këtë sure do të ringjallet në shoqërinë e ‘Aliut në Ditën e Gjykimit dhe do të jetë me shoqëruesit e tij.”

101. el-Kari’e

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se atij që e reciton këtë sure Allahu do t’ia bëjë peshoren e veprave të mira të rëndojë. Imam Xha’fer es-Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të marrë siguri nga Allahu Te’ala ndaj fitnes së Dexhhalit, besimit në të dhe kutërbimit të Xhehenemit.

102. et-Tekathur

Pejgamberi Fisnik (s) citohet duke thënë se ai që e lexon këtë sure nuk do të gjykohej nga Allahu, i Madhëruar e i Lartësuar qoftë, lidhur me bekimet që Ai i ka dhuruar e do të konsiderohet sikur të kishte lexuar njëmijë vargje të Kur’anit Fisnik. Ibn ‘Umeri ka transmetuar se: “I Dërguari i Allahut (s) më pyeti njëherë: ‘A mundet ndokush nga ju të recitojë njëmijë ajete në ditë?’ Ne i thamë: ‘O i Dërguari i Allahut, e kush mundet?’ Ai u përgjigj: ‘A mundet ndonjëri prej jush të recitojë suren Tekathur?’” Profeti i Bekuar (s) citohet gjithashtu duke thënë se: “Kushdo që e reciton këtë sure kur shkon për të fjetur do të mbrohet nga sprovimi i varrit.” Transmetohet po ashtu se Imam Sadiku ka thënë që ai i cili e reciton këtë sure në namazet e detyrueshme do të ketë shpërblimet e njëmijë shehidëve.

103. el-‘Asr

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do t’i ketë veprat e tija të vulosura me durim dhe do të jetë në të mbarë Ditën e Gjykimit. Imam Xha’fer es-Sadiku ka thënë se ai që e reciton këtë sure në namazet e tija vullnetare do të ringjallet me fytyrë të qeshur dhe sytë e freskët, gjersa të hyjë në Xhennet. Ky transmetim citohet nga el-Kaf’ami dhe ‘Alame Mexhlisiu, si dhe në faqe 386, vëll. VI i *ed-Durr ul-Menthur*.

104. el-Humeze

Transmetohet se Profeti i Bekuar (s) ka thënë që recituesit të kësaj sureje do t’i jepen dhjetë shpërblime për çdo person që e ka përqeshur Pejgamberin (s) dhe sahabët e tij (r.a.). Imam Sadiku ka thënë për këtë sure: “Kujt do që e lexon atë në namazet vullnetare (*nafile*), ajo do t’ia largojë varfërinë, duke i sjellë furnizim dhe duke e mbrojtur nga vdekja tragjike.”

105. el-Filë

I Dërguari i Allahut citohet duke thënë se Allahu do ta mbrojë recituesin e kësaj sureje nga fatkeqësia dhe metamorfoza. Imam Sadiku ka thënë se ai që e këndon atë në namazet e detyrueshme do të marrë dëshmi të mirë nga çdo fushë dhe mal e copë tokë ku ai është falur dhe do të futet në Xhennet pa u gjykuar. El-Kaf'ami komenton duke thënë se shpërblime të tilla të jashtëzakonshme nuk do t'i jepen kujtdo, por janë për të sinqertit e devotshëm, ata që janë dhuntisur me dituri dhe me të vepruarit sipas saj. Kjo pikëpamje ndahet edhe nga Ibn Tausi në librin e tij *el-Ikbal*.

Shejh es-Saduk, Allahu pastë mëshirë për shpirtin e tij, citohet nga 'Alame Mexhlisiu në vëll. LXXXIX, f. 337 të veprës së tij *Bihar ul-Enuar*, duke thënë: "Kushdo që reciton Suren el-Filë në njërin rekat të detyrueshëm, duhet të recitojë Suren Kurejsh në tjetrën, sepse ato janë si një sure e vetme dhe nuk duhet recituar vetëm njëra në namazet e detyrueshme." Kjo pohohet edhe në faqe 114 të veprës *Thewab ul-A'mal*.

Imam Xha'fer es-Sadiku ka shkruar një herë me dorën e tij se: "Kurdo që përballeni me ndonjë armik duhet ta shikoni në sy dhe të lexoni Suren el-Filë.", siç transmetohet nga el-Kaf'ami dhe el-Mexhlisi.

106. Kurejsh

'Alame Mexhlisiu ka treguar se kjo sure ka të njëjtat merita si motra e saj më lart. I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se atij që e reciton atë do t'i jepen dhjetë shpërblime për çdo njeri që ka bërë tavaf dhe i'tikaf në Qa'be. Imam Xha'fer es-Sadiku ka thënë: "Kushdo që e reciton atë do të ringjallet në Ditën e Gjykimit i mbartur në një nga mbartëset e Xhennetit deri sa të ulet në tryezat e dritës në Parajsë.

107. el-Ma'unë

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se Allahu do t'ia falë mëkatet recituesit të kësaj sureje i cili do të konsiderohet gjithashtu sikur ta ketë dhënë rregullisht zekatin. El-Bataini ia gurrmon zinxhirin një thënieje të Imam Sadikut, nëpërmjet Isma'il ibn Zubjerit që citon 'Amr ibn Thabitit duke përcjellë fjalët e Imamit që nëse dikush e reciton këtë sure në namazet e tija të detyrueshme dhe ato vullnetare, Allahu do t'ia pranojë lutjet dhe nuk do ta gjykojë për çfarë ka bërë në jetën e shkurtër të kësaj bote.

108. el-Keuther

Transmetohet që Profeti i Bekuar (s) ka thënë se Allahu do ta lejojë atë që e ka recituar këtë sure të pijë nga lumejtë e Xhennetit dhe do t'i japë shpërblime sa numri i kurbanëve të ofruar nga shërbëtorët e Allahut në Kurban Bajram ose kurbane të tjera për kënaqësinë e Tij. Imam Xha'fer es-Sadiku citohet duke thënë se atij që e reciton këtë sure në namazet e tija farze dhe nfile do t'i jepet të pijë nga haudi i Keutherit dhe ai do të bisedojë me të Dërguarin e Allahut (s) e do të jetë në burimin e Tuba-s. Kjo citohet edhe në veprën *Thewab ul-A'mal*.

109. el-Kafirunë

Në faqet 339-40 të vëllimit LXXXIX të veprës së tij *Bihar ul-Enuar*, 'Alame Mexhlisiu citon nga Shejh el-Mufidi një transmetim me zinxhir të pandërprerë, në të

cilin tregohet se el-‘Assi iu drejtua njëherë Pejgamberit (s) me fjalët: “O Muhammed! Le të adhurojmë ne atë që adhuron ti e ti të adhurosh atë që adhurojmë ne, kështu që të jemi barabar dhe ti do të jesh prapë në krye. Atëherë nëse ajo që ndjekim ne është e drejtë, ti do të kesh fituar pjesën tënde, dhe nëse ti je në të drejtë, ne do të kemi fituar pjesën tonë” me ç’rast Allahu - Lavdëruari dhe i Lartmëdhuari zbriti Suren el-Kafirunë. I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se ai që e reciton këtë sure do të konsiderohet si ai që ka lexuar një të katërtën e Kur’anit, dhe shejtanët më të këqinj do t’i qëndrojnë larg e ai do të pastrohet nga shirku dhe do të lirohet nga kalimi nëpër tmerret e Ditës së Gjykimit. Ai ka thënë gjithashtu se kush e lexon atë përpara se të bjerë në gjumë do të flejë i sigurtë ndaj shirkut. Imam Xha’fer es-Sadiku citohet duke thënë se ai që e reciton këtë Sure dhe Suren Ihlasë në një nga namazet e tija të detyrueshme do të falet, ashtu si dhe prindërit e tij.

110. en-Nasr

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë se: “Kushdo që e reciton këtë sure do të konsiderohet se ka qenë i pranishëm me mua kur është hapur Meka [në çlirimin e saj].” Transmetohet gjithashtu se Imam Sadiku ka thënë se atij që e reciton këtë sure në namazet *farz* ose *nafile* do t’i jepet fitorja nga Allahu përmbi armiqtë. Në Fikh er-Rida, pohohet që nëse dikush e reciton këtë Sure në një namaz *farz* ose *nafile*, Allahu do t’i japë fitore mbi të gjithë armiqtë e tij dhe do t’ia lejojë kryerjen e obligimeve.

111. el-Leheb

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë: “Nëse dikush e reciton këtë sure, unë do të dëshiroj që Allahu të mos e lejojë kurrë të jetë në shoqërinë e Ebu Lehebit.” Imam Sadiku ka thënë për këtë sure që: “Nëse e recitoni kete sure, lutjuni Allahut ta mallkojë Ebu Lehebin, sepse ai ka qenë ndër përgënjeshtuesit e Muhammedit, paqe dhe bekime pastë mbi të dhe pasardhjen e tij, dhe e ka fallsifikuar mesazhin e tij.” Ky citim regjistrohet nga Ebu ‘Ali et-Tabarsi në veprën e tij të njohur *Muxhmau’l-Bejan fi Tefsiri’l-Kur’an*.

112. el-Ikhlāsë

Në vëllimin LXXXIX të veprës Bihar ul-Enuar, më shumë se tetëmbëdhjetë faqe, duke filluar nga ajo 344, diskutojnë meritat e kësaj sureje të madhërishtme të Kur’anit, ndër më të rëndësishmet në Kur’anin Famëlartë. I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se: “Ai që e lexon Suren el-Ikhlāsë do të jetë si ai që ka recituar një të tretën e Kur’anit dhe do t’i jepen dhjetë shpërblime për çdo njeri që ka besuar në Allah, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij dhe Ditën e Gjykimit.” Ai (s) citohet gjithashtu duke thënë: “Nëse dikush e reciton atë njëherë, do të bekohet; nëse e lexon dy herë, ai dhe familja e tij do të bekoen.” Imam ‘Ali ibn Ebu Talibi ka thënë: “Kushdo që e reciton atë njëmbëdhjetë herë pas namazit të sabahut do të ruhet nga kryerja e ndonjë gjynahu atë ditë, megjithë ndërhyrjen e Shejtanit.” El-Bataini citon Sejf ibn ‘Amiren që përcjell nga Ebu Bekr el-Hadrami duke transmetuar nga Imam Ebu ‘Abdullah es-Sadiku se: “Kushdo që beson në Allah dhe në Ditën e Fundit duhet ta recitojë Suren Ikhlāsë pas çdo namazi të detyrueshëm, sepse ai që e reciton atë do të marrë hajrin e dynjasë dhe të ahiretit, dhe Allahu do ta falë atë, prindërit e tij dhe pasardhësit e tij.”

Këtu është me vlerë të citohet një incident interesant lidhur me këtë Sure, i cili transmetohet nga 'Alame Mexhlisiu, prej Enesit, sahabiut të Pejgamberit (s):

Ishim njëherë në shoqërinë e të Dërguarit të Allahut (s) në Tebuk. Një ditë, dielli lindi me rreze dhe ndriçim që s'e kishim parë kurrë më parë. I Dërguari i Allahut (s) vazhdoi të çuditej për dritën dhe rrezet e tij. Papritur, i erdhi Xhibra'ili dhe Resuli e pyeti: "Ç'është kështu me diellin, o Xhibra'il, me atë ndriçim dhe ato rreze që s'i kam parë ndonjëherë?" Xhibra'ili iu përgjigj: "Është për shkak të Mu'avijeh ibn Mu'avijeh el-Lejthi [el-Mezniut] i cili vdiq sot në Medine; Allahu dërgoi shtatëdhjetë mijë melekë t'ia falnin xhenazen." "Përse?" pyeti Pejgamberi (s). "Sepse e kishte zakon të recitonte Suren Ikhlasë mjaft shpesh: në këmbë, ndenjtur, duke ecur, natën ose ditën." Atëherë Profeti (s) u kthye nga ne dhe tha: "Recitoheni sa të mundeni, sepse ajo përshkruan Zotin tuaj; nëse recitohet pesëdhjetë herë, Allahu do ta ngrejë recituesin pesëdhjetë mijë gradë dhe t'i largojë pesëdhjetë mijë gjynahe e t'i shkruajë pesëdhjetë mijë sevabe; dhe nëse e reciton më shumë, Allahu do t'i japë më shumë."

Ibn el-Muteuekkili citon Muhammed el-Attarin që përcjell nga el-Esh'ariu i cili transmeton nga Ahmed ibn Hilali që citon Isa ibn 'Abdullahin, duke përcjellë nga paraardhësit e tij të cilët transmetojnë nga Imam 'Aliu se i Dërguari i Allahut (s) ka thënë: "Nëse dikush e reciton Suren el-Ikhlâs kur shkon në të flejë, Allahu do t'ia falë mëkatet që ka kryer në pesëdhjetë vjet." Kurse Imam Sadiku citohet nga Sulejman ibn Khalidi, një nga nxënësit e tij, duke thënë: "Nëse dikujt i kalojnë tri ditë pa e recituar Suren el-Ikhlâsë në ndonjërin prej namazeve të tij, ai do të harrohet dhe bindja do t'i largohet, e nëse vdes në një nga ato ditë, ai do të konsiderohet si një njeri që nuk ka besuar në Allahun e Madhëruar." Kjo transmetohet në vëll. LXXXIX, ff. 349-50 të veprës *Bihar ul-Enuar* të 'Alame Mexhlisiut dhe në faqe 213 të *Thewab ul-A'mal*.

113. el-Felek

I Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se ai që e reciton këtë Sure dhe atë që i vijon do të jetë si ai që i ka recituar të gjithë Librat që Allahu i Madhërishtëm ka shpallur dhe ai, paqe e bekime pastë mbi të dhe familjen e tij i urdhëroi sahabët e tij që t'i recitonin ato pas zgjimit dhe kur të binin në gjumë.

114. en-Nas

Meritat e saj janë si ato të Sures së saj simotër, el-Felek.